

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NR.REP. 5052 NR.KOL. 3174



TAKSA E PULLËS
U LIKUJDUA

KONTRATË SHITJE

(për shitjen e kuotave të shoqërisë)

Sot me 29.10.2019 (nëzet e nente tetor dymije e nentembdhjete), ditën e marte, para meje noterit publik ne qytetin e Shijakut, Ervis Klari, me zyre ne lagjja Popullore, u paraqiten:

Pala Shitese:

Z. Sajmir Shehu, shtetas Shqiptar, atesia Halim, lindur me 03.09.1988, ne Koxhas, Durres me banim ne Koxhas Fshati Koxhas 008, Xhafzotaj, Durres, identifikuar me leternjoftim ID, me nr.personal I80903008H, ne cilesine e ortakut te vetem ne shoqerine "RESTORANT ZAMBAKU" Shpk me NUIS L82007504F, i perfaqesuar me prokure nga babai i tij, **Z. Halim Shehu**, shtetas Shqiptar, atesia Shefit, lindur me 26.03.1959, ne Ceren, Diber, me banim ne Koxhas, Xhafzotaj, Durres, identifikuar me leternjoftim ID, me nr.personal F90326179E

Pala Blerese:

Z. Ervis Miça, shtetas Shqiptar, atesia Refik, lindur me 24.07.1987, ne Durres, me banim ne Borake, Xhafzotaj, Durres, identifikuar me leternjoftim, me nr.personal I70724010C.

Palet e mesiperme jane madhore e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te cilet me deshire te plote kerkuan perpilimin e kontrates per shitjen e kuotave te shoqerise si vijon:

Baza ligjore: Neni 705 e vijues te Kodit Civil te RSH, neni 68 e vijues te ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, ligji nr. 110/2018 "Per noterine" i ndryshuar, neni 43 e vijues i ligjit nr.9723, date 3.5.2007, "Per qendren kombetare te regjistrimit", i ndryshuar, Vendimin nr.2, date 28.10.2019, i Shoqerise "Restorant Zambaku" Shpk.

Neni 1

Objekti i Kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e 100 % te kuotave te shoqerise "Restorant Zambaku" Shpk.

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

Me ane te kesaj kontrate pala shitese, ortaku i vetem i shoqerise "Restorant Zambaku" shpk, me NUIS L82007504F, zoterues i 1 (një) kuote me 100,00 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise ne vleren 100.000,00 leke siç rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar, i shet bleresit Ervis Miça, pjesen e tij 100,00% nga kapitali i shoqerise kundrejte çmimit prej 100.000,00 (njëqindmije) leke.

Pala blerese Ervis Miça, bie dakord per blerjen e kuotave nga ortaku i vetem i shoqerise "Restorant Zambaku" shpk, sipas kushteve dhe vleres te percaktuar ne kete kontrate duke u bere ne kete menyre zoterues i 100,00% te kapitalit te shoqerise "Restorant Zambaku" Shpk me NUIS L82007504F.

Palet deklarojne se çmimi prej 100.000,00 (njëqindmije) leke, eshte likujduar plotesisht jashte zyres noteriale duke mos pasur palet asnje pretendim ndaj njeri-tjetrit.



Neni 3

Te drejta dhe detyrime te paleve

Pala shitese dhe pala blerese përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, prane QKB sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 4

Te ndryshme

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin e saj prane QKB, **shoqeria "Restorant Zambaku" shpk, do te perbehet nga ortaku i vetem Z. Ervis Miça**, dhe shoqeria do te vijoje aktivitetin si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem.

Per sa me lart, palet kishin rene dakord para se te paraqiteshin perpara noterit, dhe se konceptimi i kesaj kontrate eshte bere sipas vullnetit te lire e te shprehur te paleve.

Kontrata pasi u hartua prej meje noterit ne 4-kopje me nga 2-flete, ne gjuhen u lexua, pranua e u nenshkrua nga palet, me deshire dhe vullnet te lire, perpara meje, ne zyren time noteriale.

Une noteri vertetoj kete akt ne baze te ligjit.

Pala Shitese

SAJMIR SHEHU

Ne cilesine e ortakut te vetem shoqerise
"Restorant Zambaku" Shpk

I perfaqesuar me prokure nga babai i tij
HALIM SHEHU

Halim Shehu
[Signature]

Pala Blerese

ERVIS MIÇA

Ervis Miça *[Signature]*

NOTER

ERVIS KLARI

[Signature]